



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 07 Prot

Datë, 11.03.2020

Lënda: Njoftim për vetëkandidim për anëtarë të Komisioneve të Zgjedhjeve në Fakultete (KZF) në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë

Drejtuar: Personelit Akademik
Këshillit të Studentëve

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Senatit Akademik Nr.59, datë 11.02.2020 “Për miratimin e Rregullores për organizmin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, Vendimit të Komisionit Institucional Zgjedhor Nr.2, datë 11.03.2020 “Për ngritjen e Komisioneve të Zgjedhjeve në Fakultete (KZF) në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, Komisioni Institucional Zgjedhor, hap procedurën e vetëkandidimit për anëtarë dhe sekretarë të Komisioneve të Zgjedhjeve në Fakultete (KZF). Kërkesa për vetëkandidim nga personat e interesuar duhet të dërgohet në rrugë elektronike në adresën kiz@univlor.edu.al nga data 12.03.2020, deri në datë 13.03.2020, brenda orarit zyrtar ora 8:00-16:00.

Kandidatët duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesa për vetëkandidim.
2. Kopje e dokumentit të identifikimit.

Kryetar i Komisionit Institucional Zgjedhor
Oljana Hoxhaj

Anëtarët

Shkelqim Sinanaj

Eljona Zanaj

Evis Allushi

Kristi Mucollari